

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 12, datë 21.7.2020

PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË FAQEVE PËR TË CILAT INFORMACIONI PËRFITOHET FALAS, RASTET E PËRJASHTIMIT NGA PAGESA E TARIFËS, SI DHE RREGULLA PËR MËNYRËN E KRYERJES SË PAGESËS PËR PAJISJEN ME INFORMACION QË PRODHOHET OSE MBAHET NGA AUTORITETET PUBLIKE

Në mbështetje, të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 13 dhe të pikës 3, të nenit 16, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZOJNË:

1. Personat e regjistruar në skemat e ndihmës shoqërore, si dhe subjektet përfituese, sipas ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, e përfitojnë informacionin dhe/ ose dokumentacionin pa pagesë deri në 20 fletë, për çdo kërkesë ose në vlerën ekuivalente kur informacioni jepet në një format tjetër, pas vërtetimit të statusit përkatës.

2. Subjektet përfituese janë:

- a) personat, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale;
- b) viktimat e dhunës në familje;
- c) viktimat të abuzuar seksualisht dhe viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal;
- d) viktimat të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;
- e) fëmijët, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
- f) fëmijët nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisnin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;
- g) personat që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit;
- h) personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor;
- i) personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore;
- j) personat, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, në çdo fazë të këtij procesi;
- k) personat, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisnin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për rifitimin e zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor;
- l) personat, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.
- m) personat që provojnë se kanë të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet, që do të thotë nëse të ardhurat e tyre janë më të ulëta se niveli i pagës minimale të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

3. Pas marrjes së kërkesës për informim nga subjekti kërkues, autoriteti publik, llogarit shumën që duhet paguar për riprodhimin dhe sipas rastit, për dërgimin e informacionit dhe njofton menjëherë kërkuesin.

4. Riprodhimi i dokumenteve të kërkuara do të bëhet nga drejtoria/sektori përkatës, me mjetet e riprodhimit që disponon autoriteti publik.

5. Subjekti kërkues bën pagesën e tarifës së përcaktuar nga autoriteti publik, për llogari të autoritetit publik, pranë një banke të nivelit të dytë. Një kopje të mandatit të pagesës, subjekti kërkues ia bashkëlidh kërkesës, drejtuar autoritetit përkatës.

6. Me pagesën e tarifës përkatëse dhe paraqitjen e mandatit bankar, pranë autoritetit publik, dokumentet e kërkuara nga kërkuesi i dërgohen me postë ose i dorëzohen menjëherë të interesuarit.

7. Përfshihen nga fusha e zbatimit të këtij udhëzimi, subjektet për të cilat marrja e shërbimit, përcaktohet me ligj që të jetë pa pagesë.

8. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi, autoritetet publike, që kanë detyrimin për dhënien e informacionit të kërkuar nga kërkuesi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj